

## **Formular për SYLLABUS të Lëndës**

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
Njësia akademike:	Fakulteti Edukimit, Programi Parashkollor
Titulli i lëndës:	Psikologji zhvillimore dhe personaliteti
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	II
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	12:00-13:30, Salla 131
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ass. Dr Pranvera Jetishi Çollaku
Detajet kontaktuese:	044/621-873, <a href="mailto:pranvera.jetishi@uni-prizren.com">pranvera.jetishi@uni-prizren.com</a>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	
	Programi i lëndës Psikologji e Zhvillimit dhe Personalitetit ofron për studentët, shpjegime teorike dhe informacion bashkëkohor rreth kuptimit të zhvillimit dhe personalitetit njerëzor si dhe karakteristikave zhvillimore që manifestohen në çdo periudhë të jetës. Përfshirja në studim e gjithë fazave të jetës ose e të gjitha moshave zhvillimore, ka për qëllim të përmbushë jo vetëm nevojat e ngushta profesionale të studentëve për të punuar me një grup-moshë të caktuar fëmijësh apo të rriturish, por edhe të kompletojë kulturën e tyre vetjake, për të reaguar në mënyrë të përshtatshme ndaj ndryshimeve personale ndër vite dhe për të rritur cilësinë e ndërveprimit me të tjerët, qofshin këta kolegë pune, mësues të shkollës, prindër nxënësish, të afërm, etj.
<b>Qëllimi i lëndës</b>	Lënda ka për qëllim aftësimin e studentëve që të kuptojnë më mirë zhvillimin e njerëzimit që nga lindja se si ndodhë në të gjitha fushat si në aspektin fizik, mendor (kognitiv) gjuhësor, emocional, social dhe moral si dhe personalitetin dhe periudhat e zhvillimit të tij bashkë me strukturën dhe dinamikën e personalitetit.
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të kuptojmë procesin e zhvillimit njerëzor dhe forcave kryesore që qëndrojnë mbrapa këtij zhvillimi (të përkufizojnë zhvillimin),</li> <li>- Të vlerësojnë nga këndvështrime të ndryshme teorike procesin e ndryshimeve zhvillimore që ndodhin në stadet e jetës (ti njohin teoritë e zhvillimit njerëzor),</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të përshkruajnë dhe shpjegojnë ndryshimet që ndodhin gjatë zhvillimit prenatal,</li> <li>- Të njohin faktorët që ndikojnë në zhvillimin e sjelljes motorike gjatë foshnjërisë (reflektet, maturimi, dhe gatishmëria për të mësuar),</li> <li>- Të kuptojnë zhvillimin e personalitetit gjatë foshnjërisë,</li> <li>- Të kuptojnë dhe analizojnë progresin fizik, njohës dhe psiko-social që ndodh në vitet e fëmijërisë së hershme,</li> <li>- Të njohin zhvillimin fizik dhe pubertetin në fazën e adoleshencës,</li> <li>- Të njohin problemet themelore të personalitetit dhe të zhvillimit social në adoleshencë,</li> <li>- Të njohin zhvillimin në moshën e rritur,</li> <li>- Të njohin stadet e rëndësishme të zhvillimit të personalitetit dhe zhvillimit social të rriturit,</li> </ul>
--	--

**Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)**

<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren	/	/	/
Kollokfiume,seminare	1	2	2
Detyra të shtëpisë	/	/	/
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	2	5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	3	6
Projektet,prezentimet ,etj	1	2	2
<b>Totali</b>	Vërejtje: 1 ECTS kredi= 25 orë angazhim,psh nëse lënda i ka 6 ECTS kredi student		125

	duhet të ketë angazhim gjatë semestrit 150 orë		
<b>Metodologjia e mësimëdhënies:</b>			
	<p>Ligjërata, ushtrime, diskutime, punime seminarike, konsultime, teste, raste studimi, detyra etj.</p> <p>Kursi do të realizohet përmes metodave të kombinuara, varësisht nga natyra e ligjërates, duke përfshirë: ligjërata të rregullta, ushtrime praktike, diskutime në grup, involvimin në prezantime dhe punime seminarike të temave relevante me kursin, punë ekipore për analizimin dhe zhvillimin e hulumtimeve të vogla lidhur me temat e studimit, konsultime gjatë gjithë semestrit. Kryesisht do të dominojë metoda e mësimit interaktiv si dhe do të aplikohen variante të ndryshme shpjegimi si: sqarimet, diskutimet, debatet, analizat, pyetje, detyra etj.</p>		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>			
	<b>Vlerësimi</b>		
	<p>Pjesëmarrja aktive përfshinë 10% të vlerësimit  Kolokiumi i parë përfshinë 30 % të vlerësimit  Punimi seminarik përfshinë 30 % të vlerësimit  Kolokiumi i dytë përfshinë 30 % të vlerësimit</p> <p>Provim Final përfshinë vlerësimin 100% nga lënda</p>		
	<b>Vlerësimi në %</b>	<b>Nota përfundimtare</b>	
	91 – 100	10 ( ECTS – A)	
	81 – 90	9 ( ECTS - B)	
	71 – 80	8 ( ECTS - C)	
	61 – 70	7 ( ETCS - D)	
	51 – 60	6 ( ETCS - E)	
	40 - 50	5* ( ETCS – FX)	
	00 - 39	5 ( ETCS - F)	
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura bazë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pranvera Jetishi, “<i>Ligjërata të përgatitura nga lënda: Psikologji zhvillimore dhe Personaliteti</i>”, Prizren 2020</li> <li>• Voltisa Lama, <i>Zhvillimi i fëmijës</i>, UETPRESS, Tiranë, 2015</li> </ul>		

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Theodhori Karaj “<i>Psikologjia e zhvillimit të fëmijës</i>”, Progres, Tiranë, 2005</li> <li>• Ross Vasta, Marshall M.Haith, Scott A. Miller “<i>Psikologjia e fëmijës</i>” UEGEN, Tiranë, 2007</li> <li>• George Boeree “<i>Teoritë e personalitetit</i>” Plejad, Tiranë, 2004</li> </ul>
<b>Literatura shtesë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pajazit Nushi “<i>Psikologjia e Përgjithshme I</i>” Libri Shkollor, Prishtinë, 2002</li> <li>• Reno H. Largo “<i>Vitet e foshnjërisë</i>” Tiranë, 2000</li> <li>• Jonni Kincher “<i>Psikologjia për fëmijët</i>” Tiranë, 2006</li> <li>• Edmond Dragoti “<i>Adoleshenti</i>” ALBDESING, Tiranë, 2005</li> </ul>

**Plani i dizajnuar i mësim:**

<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	Prezantimi i syllabusit, Hyrje në psikologjinë e zhvillimit
<b>Java e dytë:</b>	Konceptet historike dhe filozofike lidhur me fëmijërinë, Teoritë për zhvillimin njerëzor- Teoria psikoanalitike
<b>Java e tretë:</b>	Teoria e procesimit të informacionit, Teoria e zhvillimit psikosocial e Eriksonit, Teoritë kognitiviste,
<b>Java e katërt:</b>	Teoritë bihevioriste, Teoria sociale e të mësuarit, Teoria e vetëefikasitetit, Teoritë humaniste, Teoritë etologjike
<b>Java e pestë:</b>	Bazat biologjike të zhvillimit, Zhvillimi para lindjes dhe procesi i lindjes, i sapolinduri
<b>Java e gjashtë:</b>	Zhvillimi fizik, motorik, perceptiv dhe kognitiv në foshnjëri,
<b>Java e shtatë:</b>	<b>Testi I</b>
<b>Java e tetë:</b>	Zhvillimi psikosocial në foshnjëri
<b>Java e nëntë:</b>	Zhvillimi fizik, kognitiv dhe gjuhësor në moshën parashkollore
<b>Java e dhjetë:</b>	Zhvillimi psiko-social në moshën parashkollore
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Zhvillimi fizik, kognitiv dhe psiko-social në fëmijërinë e mesme
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Zhvillimi fizik, kognitiv dhe psiko-social në moshën e adoleshencës
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Zhvillimi i personalitetit, faktorët e zhvillimit të personalitetit
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	Roli i familjes, shkollës dhe shoqërisë në zhvillimin dhe formimin e personalitetit njerëzor
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	<b>Testi II</b>

**Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

- Gjatë provimit ndalohet kopjimi dhe çdo formë tjetër e punës jo të përshtatshme me rregullat e provimit.
- Po ashtu ndalohet plagjiatura dhe mos citimi i burimeve të përdorura për punim të punimeve seminarike.